Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova
ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES
Nr.Inv/Br.Inv 05-553/01-26625
Nr. faqeve/Br.Str./No.Pg. 0806626
Data/Datum/Date
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Universum International College
Powered by Arizona State University

GJAKOVA

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNI –Universum International College Powered by Arizona State University

Dhe **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) në Komunën e Gjakovës**
QKMF Gjakove

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, QKMF Gjakove , do t'u mundësoj studentëve të Programeve Shëndetësore të Kolegjit UNI përfundimin e oreve të praktikes në QKMF Gjakove, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.

2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji UNI do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga përgjegjësi i caktuar nga QKMF Gjakove.

3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji UNI, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e Ordinances dhe QKMF Gjakove.

4. Kolegji UNI do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë

përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është me afat kohor nje vjeqar.

5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 05.06.2026

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNI – Universum

Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) në Komunën e Gjakovës

Lulzim Goqi
Drejtori